REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
14. 08. 2020

| Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit | Shif.klasif. / Klasif. Kod / Class. Code | Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No. | Nr. i faqeve / Br. Stranica / No. Pages |
|---|---|---|---|
| 04 | 47 | 1444 | 7 |


REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT

OPSTINA LIPJAN

LIPJAN MUNICIPALITY

## Komuna e Lipjanit
## Zyra e Kryetarit

## Plani i Zabatimit të rekomandimeve të pranuara me Raporin Final nga Auditori i Zyrës kombëtare të Kosovës për vitin 2019 të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit

| Të Gjeturat në Raportin e ZAP | Rekomandimet | Zyrtari përgjegjës për implementimin e rekomandimit | Aktivitetet e përcaktuara për implementimin e rekomandimit | Afati kohor i përmbushjes | Gjendja e aktiviteteve te ndërmarra me rastin e rishikimit |
|---|---|---|---|---|---|
| Thesari përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore kishte ekzekutuar pagesa në emër të komunës në vlerë 148,720€, për paga jubilare dhe përcjellëse[6] pas pensionimit, dhe për obligimet e bartura[7] nga vitet 2011-2014 për paga të mësimdhënëseve. Nga kjo shumë 45,974€ ishin paguar nga Investimet | **Rekomandimi C1** Kryetari duhet të siguroj se janë evidentuar dhe përllogaritur të gjitha rastet e stafit të pensionuar që pretendojnë kompensimin e | ZKA DBF ZKF - | - Ne secilin vite ne do te sigurojm nje evidence te sakte per te gjitha obligimet qe kemi ne paga numrin e punetoreve qe shkojn ne penzion, pagesen e pagave jubilare, pagën e | 2021 | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Kapitale, 97,982€ nga Mallrat dhe Shërbimet dhe 4,764€ nga Subvencionet e Transferet. Shpenzimet e tilla përveç që janë bërë nga kategoritë joadekuate të shpenzimeve, kanë shkaktuar edhe ngarkesë të buxhetit të komunës për shpenzimet shtesë për procedurat përmbarimore në vlerë 33,085€.<br>Kjo ka ndodhur në mungesë të aprovimit të buxhetit për këto pagesa dhe si rezultat i mungesës së mjeteve në kategorinë e pagave. Po ashtu Obligimet e bartura nga vitet paraprake kanë ndodhur shkaku i tejkalimit të numrit te të punësuarve pa planifikim dhe nuk ka qenë e mundur të vendosen në listat e pagave për periudhën aktuale.<br>Bazuar në Udhëzuesin Administrativ NR. 19/2009 për planin kontabël për përdorim nga Organizatat Buxhetore – Kodi ekonomik nënkupton natyrën e shpenzimeve dhe të hyrave në regjistrin e buxhetit. | pagave jubilare dhe përcjellëse, në mënyrë që të planifikohet edhe buxheti për to. Po ashtu të gjitha obligimet duhet të paguhen me kohë dhe të shmanget mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore, kamatë vonesa dhe shpenzime të përmbarimit. | | shujtave ne arsim pasi qe me kontraten kolektive te gjitha keto i bijen barre Komunës.<br>- Lidhur me kete do te i dergojm nje shkrese Ministrise se Arsimit qe te parashihen me qarkore buxhetore Ministrise se Financave per ndarjen e mjeteve ne kategorin e pagave qe kane ndikim nga kontrata kolektive. | | |
| Bazë për kompensimin e pagave dhe shtesave eventuale duhet të jetë kontrata e punës dhe dëshmitë se punonjësit kanë punuar gjatë muajit përkatës. Komuna kishte vazhduar të kompensoj 20 zyrtarë/zjarrfikës, në mungesë të informatave (kontratave dhe dëshmive të punës). Kjo ka ndodhur për shkak se këta zyrtarë, sipas legjislacionit në fuqi, | **Rekomandimi A1**<br>Kryetari, deri në bartjen e buxhetit tek MPB-ja, duhet të kërkoj nga personat përgjegjës, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës të sigurohen së paku | - ZKA<br>-Drejtoria për Mbrojtje dhe Eemrgjencë<br>-zyra e personelit | Për tu sigurar se janë paguar vetëm punëtorët legjitim ne si drejtorat i DMSH-së,do të kërkojmënga Komnadanti i NJpZSH-së që për çdo rekutim të ri të na njoftoj me shkrim për procesin e rekrutimit dhe kotratën e punës një kopje . | Prej Muajit Gusht | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| konsiderohen si punëtorë të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme(MPB) dhe në bazë të marrëveshjeve të mirëkuptimit, të gjitha kompetencat rreth menaxhimit, përfshirë menaxhimin e dosjeve të punëtorëve janë bartur nga komuna në AME respektivisht MPB, me përjashtim të buxhetit i cili ka mbetur tek komuna. Prandaj komuna kryen vetëm kompensimin e pagave dhe shtesave nga buxheti i saj. Pagat dhe shtesat për këta punëtorë gjatë vitit 2019 ishin 124,377€. Kjo çështje do të vazhdoj të përsëritet vit pas viti, derisa Ministria e Financave nuk ndërmerr hapa për bartjen e buxhetit në MPB. | dosjet me informata bazike përfshirë kontratat e punës, si dhe raportet mujore për vijueshmërinë e tyre në punë, për t'u siguruar se janë paguar vetëm punëtorët legjitim dhe që kanë ofruar shërbimet. | | -do të kërkojmë që në baza mujore të na sigurohet lista e nënshkruar e pagave dhe e verifikuar nga Komandanti i NJPZSH-së, para se të nënshkruhen nga Drejtori i DMSH.<br><br>-Në baza mujore Drejtori i DMSH-së do të kërkoj kopjet të dëshmive mujore për shkuarje –ardhjet e punëtorëve<br><br>Të gjiha këto kontrolle do të kryhen derisa buxheti I NjPZSH-së do të menaxhohet nga DMSH gjegjësisht nga komuna. | 2020 | |
| Bazuar në kushtet e kontratës parashihen edhe ndëshkime/penale ndaj palëve në rast të mos-përmbushjes së obligimeve sipas orareve dhe specifikave të kontraktuara. Më tej, Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli/shërbimi, dhe pas pranimit të faturës bëhet pagesa.<br>Te kontrata "Furnizimi me inventar | **Rekomandimi A2** Kryetari i komunës duhet të sigurohet që kontratat zbatohen sipas planit, dhe të aplikohen ndëshkimet në rastet e vonesave sipas kushteve të kontratës. Po ashtu Kryetari duhet të siguroj funksionimin efikas të | Drejtoria e prokurimit | Kontrata menaxhohet nga menaxheri i cili është caktuar për menaxhimin e asj kontrate. Drejtoria e prokurimit do të veproi sipas njoftimeve që bënë menaxheri i kontratës. Varësisht çfar janë ato njoftime,<br>Drejtoria e Prokurimit, mund të i ep vërejtje, mund ta ndëshkoi apo dhe mund të vie deri tek | Drejtoria e Prokurimit , vepron menjëher me të marr njoftimin nga menaxheri i Kontratës | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| për nevojat e Komunës së Lipjanit" me datë 09.07.2019 në vlerë prej 7,483€, Operatori ekonomik nuk ka qenë i gatshëm për të realizuar gjithë furnizimin sipas kushteve të kontratës, si dhe menaxheri i kontratës nuk ka kërkuar nga departamenti i prokurimit që të zbatoj ndëshkimet për vonesa ndaj OE. Përveq kësaj, për të gjitha furnizimet nga kjo kontratë (gjithsej 18 fatura), fillimisht ishte bërë pranimi i mallit nga depoisti e pastaj, në kohëzgjatje prej një deri në dy muaj, pas pranimit të mallit ishte proceduar urdhërblerja, pranimi i faturës dhe më pas ishte bërë pagesa. | mekanizmave dhe kontrolleve financiare, me qëllim që të respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave. | Menaxheri mbikëqyrës i kontratës | shkëputja e Kontratës<br><br>Menaxheri i Kontratës në rastet kur vonesat bëhen nga operatori Ekonomik do të kërkoj zbatimin e penaleve për rastet e mos zbatimit të planit dinamik | | |
| Bazuar në Rregulloren MF. NR. 04/2017, neni 6 – Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë Zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë ZKM.<br>Komuna e Lipjanit edhe pse me Buxhet të Kosovës ka parapa që gjatë vitit 2019 të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e OJQ-ve, nuk e ka përmbushur kërkesën ligjore për të plotësuar formularin e Planit Vjetor të Mbështetjes Financiare për të dërguar në ZKM-ZQM. Kjo situatë ka ndodhur | **Rekomandimi A3**<br>Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarr hapa në përmbushjen e kërkesave ligjore për vitet e ardhshme, të përgatitet Plani Vjetor për Mbështetjes Financiare 30 ditë pas miratimit të Buxhetit, si dhe të dhënat që përfshihen në plan të korrespondojnë me Buxhetin e Miratuar. | Zyra e kryetarit-zyra ligjore<br><br>DRKS | Duke pasur parasyshë rekomandimin A3, DKRS për vitin e ardhshëm do të përgatit planin vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve për komunën e Lipjanit, pasi kjo kërkohet të prezentohet jo me larg se 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor.<br>Mbështetjet financiare të OJQ-ve në komunën e Lipjanit janë realizuar në formë të shpalljeve publike, varësisht nga kërkesat dhe nevojat e dalura gjatë vitit. | Prej fillimi te vitit 2020 | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| për shkak të mungesës së komunikimit ndërmjet Zyrës për Qeverisje të Mirë në ZKM që ka të bëjë me rëndësinë e këtij plani dhe Komunën që është përgjegjëse për të mbështetur kërkesat ligjore. | | | | | |
| Bazuar në kushtet e kontratës parashihet data e fillimit dhe përfundimit të gjitha punëve sipas ditëve dhe jo më vonë se data e fundit e përcaktuar sipas afatit të kontratës përkatëse.<br>Kontrata e nënshkruar në nëntor të vitit 2018 në vlerë prej 292,555€ për "Rregullimin e fushës së futbollit në Magure" kishte vonesa në realizimin e punimeve për dy muaj nga shtatori deri në nëntor 2019 për shkak të vështirësive të paraqitura gjatë gërmimit dhe vonesave nga kompania projektuese për ndërhyrje të ndryshimit të projektit ekzistues.<br>Kontrata e nënshkruar në qershor të vitit 2019 në vlerë prej 129,798€ për "Ndërtimin e rrugës me trotuar, ndriçim publik në lagjen e Konjuhit rreth shtratit të Lumit Janjevka në Lipjan" kishte vonesa në realizimin e punimeve për pesë muaj nga gushti deri në dhjetor të 2019, për arsye se me projektin ekzistues nuk janë marr parasysh shpronësimet, nevojitej ri projektim i projektit.<br>Përveç kësaj komuna po përballet me | **Rekomandimi C2**<br>Kryetari duhet të sigurohet se asnjë dokumentacion i tenderit të mos lejohet pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit, i cili përcakton qartë natyrën dhe karakteristikat e performancës për punët e kërkuara, në mënyrë që të jetë i mundshëm realizimi i punëve sipas planit dinamik. | DSHP<br><br>Drjetoria e prokurimit | Drjetoria e Shërbimeve Publike , para se ta dergoj specifikimin teknik për fillimin e procedurës së prokurimit , do të angazhoj zyrtarët nga SMP për kontrollimin e para masën dhe parallogarit në përputhje me projektin detal dhe situatën faktike në terren .<br><br>Drejtoria e prokurimit do të veproi sipas njoftimeve që bënë menaxheri i kontratës. Në bazë të kushteve të përshkruara nga menaxheri i Kontratës, Drejtoria e Prokurimit ka bërë vazhdimin e planit dinamik për kryeejen e punimeve. | Nga Muaji Shtator 2020<br><br>Drejtoria e Prokurimit , vepron menjëher me të marr njoftimin nga menaxheri i Kontratës | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| moszbatim të planit dinamik për përfundim të punëve me kohë për shumicën e projekteve. Kjo është verifikuar nga dëshmitë për zgjatjen e afatit si shkak i vështirësive të paraqitura për të realizuar planin projektues.<br>Vonesat në realizimin e punimeve kanë ndodhur për shkak të defekteve të hartimit të projekteve nga kompania projektuese, pasiqë nuk është përcaktuar saktë natyra dhe karakteristikat e performancës për punët e kërkuara. | | Menaxherët e kontratave<br><br>Menaxheri i kontratës për projektim | Menaxheri i kontatës me rastin e nënshkrimit të Plani të Menaxhimit të kontratës , do të rishikoj të gjitha pozicionet para se të fillohet me zbatimin e projektit , ndërsa gjatë fazës së zbatimit të projekteve dhe vonesave që shkaktohen nga OE , do të propozoj zabtimin e penaleve .<br><br>Me rastin e pranimit të projektit detal nga Kompania projektuese do të sigurohet se nuk ka gabime përmbajtësore në projekt . | Nga Muaji shtator 2020<br><br>Nga Muaji shtator 2020 | |
| Llogaritë e arkëtueshme janë shuma të faturuara e të pa arkëtuara për shërbimet të cilat i ofron komuna për klientët e saj.<br>Për kundër faktit se komuna ka marr masa lidhur me inkasimin e llogarive të arkëtueshme duke dërguar vërejtje dhe lëndë në përmbarim, rritja e tyre vit pas viti po ndodh kryesisht me tatimin në pronë. Kjo rritje ishte e ndikuar nga borgjet e ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në vlerë prej 660,659€, si dhe nga pronat të cilat janë të regjistruara në bazën e tatimit si prona të Lipjanit në vlerë | **Rekomandimi C3**<br>Kryetari duhet të siguroj veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP- në që çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit të tyre. Po ashtu të intensifikoj dhe të risë nivelin e | DBF- menaxheri i tatimit në Prone DTP-MF | *Ne vazhdimisht i kemi përcjellur kërkesat në AKP- për pagesën e obbligimeve të Ndërrmarrjeve Shoqërore me rastin e privatizimit, dhe iu kemi përgjigj secilës kërkesë, edhe gjatë vitit 2020 ne secilës kërkesë të AKP do t`iu përgjigjemi duke iu specifikuar secilin obligim të ndërrmarrjeve shoqërore me rastin e privatizimit.<br>*Sa i përketë liststë së | Nga Muaji Gusht | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| prej 22,700€, mirëpo këto prona sipas ligjit të Kadastrit i takojnë komunës së Graqanicës. Bartja e pronave nga një komunë në tjetrën duhet të bëhet nga Departamenti i tatimit në pronë në MF. Kjo gjë ende nuk ka ndodhur edhe pas iniciativës nga zyra e tatimit në pronë të komunës. | koordinimit me Departamentin e tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave për bartjen e pronave që nuk i takojnë komunës. | | pronave të cilat duhet të kalojnë në zonën Kadastrale të Graqanicës e të cilat vazhdojnë të janë në zone kadastrale Lipjan, në Lagje të Re, ne edhe këtë vitë do ti përsërisim kërkesat në mënyrë që këto prona të barten nëKomunën e Garaqanicës. | | |

**Lipjan**

**04.08.2020**

**Miratoi : Kryetari i Komunës**

**z. Imri Ahmeti**

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT LIPJAN OPŠTINA LIPLJAN REPUBLIKA KOSOVO